



Co-funded by  
the European Union



## ARTE – ARTI për Europën

**Autoriteti financues:** European Education and Culture Executive Agency (EACEA)

**Thirrja:** CERV-2025-CITIZENS-TOWN-NT

**Periudha e realizimit:** 01/12/2025 – 30/11/2027

### Përmbledhje

**ARTE** synon të krijojë një rrjet midis pesë qyteteve — Mola di Bari (Itali), Shkodër (Shqipëri), Guimarães (Portugali), Tuzi (Mal i Zi) dhe Selanik (Greqi) — për të promovuar nisma të përbashkëta kulturore, bashkëpunim të qëndrueshëm dhe shkëmbim njohurish.

Qëllimi kryesor është të rritet pjesëmarrja e të rinjve në jetën sociale, kulturore dhe ekonomike të Bashkimit European — duke u lejuar atyre të shprehin vizionin e tyre për Evropën përmes artit, duke bashkuar njerëzit që jetojnë në BE dhe në vendet candidate përmes aktiviteteve të mëposhtme:

- **Trajnime online** për të rinjtë (mosha 18–30 vjeç) në të gjitha vendet partnere — me informacione rreth historisë së Bashkimit Evropian, mundësive për punë, studime, zhvillim personal dhe profesional, lëvizje, dhe perspektiva për të rinjtë në BE.
- **Workshop-e artistike lokale** në çdo vend partner — ku të rinjtë do të shprehin vizionin e tyre për Evropën, pritshmëritë e tyre si qytetarë (aktualë ose të ardhshëm) europianë — përmes artit: p.sh. këngë, pikturë, sculpture, vizatime, vallëzim, instrumente muzikore, etj.
- **Evente ndërkombëtare** — në Itali, Portugali dhe Shqipëri — për të ekspozuar produktet artistike të krijuara gjatë workshop-eve, për të ndarë përvojën e të rinjve, dhe për të lejuar qytetarët, të ftuarit dhe ekspertët ndërkombëtarë të njihen më mirë me historinë dhe politikat e BE-së, të diskutojnë për anëtarësimin dhe rolin e Evropës, dhe për të forcuar kohezionin social dhe politik.

### Partnerët

- ESCOOP (Itali) — Partneri Lider [ESCOOP - The first European Social Cooperative - ESCOOP European Social Cooperative](#)
- Bashkia Shkodër (Shqipëri) [Bashkia Shkoder – Eksploroni faqen e Bashkise Shkoder](#)
- DESINCOOP (Portugali) [DESINCOOP](#)
- Komuna Tuzi (Mal i Zi) [Naslovna - Opština Tuzi](#)
- ARSIS, Selanik (Greqi) [Αρχική | ARSIS](#)

